



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

UDHËZIM

Nr. 01 Datë 20. 02. 2018

PËR KRIJIMIN E SEKSIONEVE TË POSAÇME

Në mbështetje, të nenit 148/b shkronja "b" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 38, pika 2, shkronja "b", nenit 46, pikat 1, 2, 3, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr. 413 prot., datë 02. 02. 2018 dhe nr. 937 prot., datë 02. 02. 2018, mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm;

UDHËZOJ:

KREU I

ORGANIZIMI I SEKSIONEVE

1. Në përbërje të strukturës së Prokurorisë për Krime të Rënda, Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier, Shkodër, Lezhë, Korçë, Gjirokastrë, të krijohen seksionet e posaçme të përkohshme, me objekt, hetimin e veprave penale sipas kompetencës të përcaktuar në kreun II të këtij Udhëzimi.
2. Pranë Prokurorisë së Përgjithshme, caktohet një prokuror/ kordinator ndërmjet Seksioneve të Posaçme dhe Task Forcës Qendrore Ndërinstitucionale, sipas Marrëveshjes.
3. Numri i prokurorëve sipas prokurorive do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Prokuroritë	Nr. i Prokurorëve
1	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	5
2	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	3
3	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan	3
4	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër	3
5	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë	3
6	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë	3
7	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier	3
8	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë	3

9	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	3
10	Prokuroria për Krime të Tiranë	4

4. Në përbërjen e këtyre Seksioneve, Drejtuesi i Prokurorisë cakton ata prokurorë të cilët kanë përvojë në hetimin e veprave penale në fushën e krimit të organizuar, krimit ekonomik dhe korrupsionit, krimit në fushën e lëndëve narkotike dhe krimit kundër pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale si dhe kalojnë me sukses procesin e verifikimit të integritetit moral dhe profesional nga Prokuroria e Përgjithshme.
5. Një nga prokurorët e Seksionit të caktohet Drejtuesi i Seksionit.
6. Drejtuesit e Prokurorive u sigurojnë prokurorëve të këtyre Seksioneve shërbime logjistike dhe mbështetëse të veçanta. Në ato raste, kur numri i çështjeve, sipas kompetencës lëndore të përcaktuar në Marrëveshje, është i vogël, drejtuesi i prokurorisë mund të ngarkojë prokurorët e Seksionit edhe me hetimin e çështjeve të tjera.
7. Prokurorët e caktuar në këto Seksione bashkëpunojnë me shërbimet e policisë gjyqësore pranë Task - Forcës Speciale Qendrore, Task - Forcës Speciale Rajonale për shkëmbimin e informacionit, për kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të përbashkëta rreth grupeve kriminale si dhe realizimin e veprimtarisë hetimore në zbatim të detyrimeve specifike, të përcaktuara në Planin e Veprimit kundër Krimit të Organizuar, Operacioni “Forca e Ligjit”.
8. Drejtuesi i Seksionit, brenda 10 ditëve të para të çdo muaji raporton të dhënat statistikore tek prokurori/kordinator në Prokurorinë e Përgjithshme.
9. Prokurori/kordinator në Prokurorinë e Përgjithshme, çdo tre muaj, zhvillon takime të përbashkëta me drejtuesit e Seksioneve dhe drejtuesit e Task - Forcave për të diskutuar problematika të organizmit të punës.
10. Prokurori/kordinator në funksion të përmirësimit të punës së Seksioneve mund të propozojë masa të ndryshme organizative.

KREU II KOMPETENCAT LËNDORE DHE TOKËSORE

1. Kompetencat dhe veprimtaria e këtyre Seksioneve në përbërje të strukturës së Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Gjirokastrë, Lezhë dhe Prokuroria për Krime të Rënda do të ushtrohen nga data ____ 02. 2018 deri në krijimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme, bazuar në aktet ligjore në fuqi dhe në Marrëveshje.
2. Kompetenca lëndore e këtyre seksioneve do të jenë veprat penale që referohen në Seksionet e Posaçme, sipas kompetencës lëndore dhe tokësore nga Task - Forca Speciale Qendrore, Task - Forca Speciale Rajonale, si më poshtë:

- a. Vepra penale në fushën e lëndëve narkotike dhe fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.
 - b. Vepra penale në fushën e korrupsionit.
 - c. Vepra penale kundër pasurisë, në sferën e ekonomisë dhe shoqërive tregtare.
 - ç. Vepra penale në fushën e tatim - taksave.
 - d. Sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale, sipas ligjit Nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar,
 - e. Vepra penale të kryera nga subjekte të posaçme, përcaktuar në nenin 135/ 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Prokurorët e caktuar në Seksionin e Posaçëm do të vazhdojnë të hetojnë dhe përfaqësojnë akuzën në gjykim për çështjet penale që kanë në hetim dhe gjykim deri në momentin e caktimit në Seksion.
 4. Në rastet kur, një nga veprat penale objekt i këtij udhëzimi kryhet në rrethet ku nuk mund të ngrihen Seksione sipas ligjit, Prokurori i Përgjithshëm mund të caktojë përkohësisht prokuror nga Seksionet e prokurorive brenda qarkut ku ndodh vepra penale ose nga qarqet më të afërta.

KREU IV SHPËRNDARJA E ÇËSHTJEVE

1. Materialet e referuara në Prokuroritë ku krijohen këto Seksione i nënshtrohen shortit ndërmjet prokurorëve të Seksionit, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 53 dhe Udhëzimit Nr. 3, datë 29. 12. 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi drejtuesit e prokurorive të rretheve gjyqësore, Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Lezhe, Shkodër dhe drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda.
2. Ngarkohet Drejtoria e Subjekteve të Posaçme, Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Studimeve, Projekteve, Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore për ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi.
3. Ky udhëzim është i detyrueshëm dhe hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU

